



Prishtinë: 02.09.2021
Kodi i ZRRE-së: V_1382_2021

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2207_07_21**;
- Ankesën e konsumatorit të dt. 05.08.2021;

në seancën e mbajtur më datë **02.09.2021** nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit F.M. nga Komuna e Fushë Kosovës, si e pabazuar.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK_V_2207_07_21, i datës 07.07.2021.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve me datë 07.07.21 ka marrë vendim me nr. ZRrE/DMK_V_2207_07_21 me të cilin e ka aprovuar pjesërisht ankesën e konsumatorit F.M nga Komuna e Fushë Kosovës dhe e ka obliguar KESCO-n që ta korrigjojë në vlerën prej **-214.56€** nga korrigjimi plotësues i dt.20.02.2019 dhe se për diferencën e mbetur t'i ofrohej konsumatorit një marrëveshje pagese me nëntë (9) këste mujore.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, konsumatori F.M, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRrE-së për këto shkaqe:

- Krahasimi i bërë i shpenzimeve pas vitit 2016 me periudhën paraprake është i pa qëndrueshëm sepse banesa ka qenë e pabanueshme;
- Shpenzimet e energjisë elektrike në njehsorin elektrik me nr.39698230 kanë qenë kryesisht në ndriçim sepse banesa ka qenë e papërfunduar;
- Banimi dhe njëkohësisht shfrytëzimi – shpenzimi i energjisë elektrike fillon në fillim të vitit 2016.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 02.09.2021 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.



Lidhur me pretendimin e konsumatorit se krahasimi i shpenzimeve pas vitit 2016 me periudhën paraprake se është i paqëndrueshëm sepse banesa ka qenë e pabanueshme, Bordi i ZRrE-së thekson se e ka analizuar me kujdes Procesverbalin për pranimin e instalimit elektrik me nr.0088936 i dt.27.01.2016, korrigjimin nr.93947DPR-90110761 të datës 20.02.2019, ankesën e konsumatorit në KESCO të dt.26.02.2019 si dhe përgjigjen e KESCO-s të dt.28.03.2019, rrjedhën e energjisë elektrike dhe transaksionet e konsumatorit dhe ka vërtetuar si në vijim:

KWh e regjistruar në procesverbalin për pranimin e instalimit elektrik nr.0088936 të dt.27.01.2016 për njehsorin nr.39071862 janë evidentuar dhe faturuar në CCP, por që kjo nuk ka figuruar në transaksione, e që do të duhej të evidentohej edhe në transaksionet e konsumatorit, respektivisht të evidentohej edhe ngarkesa financiare. Pra lidhur me këtë, KESCO ka vepruar saktë kur ka evidentuar në rrjedhën e energjisë elektrike shpenzimin e njehsorit elektrik nr.39071862 të periudhës 02/2016, por që ka gabuar kur nuk e ka ngarkuar konsumatorin në vlerën financiare në transaksionet e konsumatorit. Megjithatë, duhet theksuar se, sipas shkresave të lëndës **ky shpenzim është bërë** dhe si i tillë ky shpenzim do të duhej të ngarkohej.

Po ashtu, duke iu referuar rrjedhës së energjisë elektrike si dhe transaksioneve të konsumatorit, Bordi i ZRrE-së ka konstatuar se konsumatori me datë 26.02.2016 është ngarkuar me faturën për shërbime për lidhje të re në vlerë **118.00€** duke i hapur shifra DPR-90110761, si dhe vërtetohet se kWh e evidentuara në procesverbalin për pranimin e instalimit elektrik nr.0088936 të datës 27.01.2016 janë evidentuar edhe në CCP me datë 26.02.2016.

Andaj, nga sa u tha më sipër, Bordi i ZRrE-së ka vlerësuar se shpenzimi i energjisë elektrike i kontestuar nga konsumatori është bërë nga vet ai dhe një gjë e tillë mund të provohet nga procesverbali për pranimin e instalimit elektrik me nr. nr.0088936 të dt.27.01.2016 për njehsorin nr.39071862 dhe se organi i shkallës së parë, respektivisht DMK me të drejtë ka konstatuar se korrigjimi nr.93947DPR-90110761 të datës 20.02.2019 përmban kWh e evidentuara në procesverbalin për pranimin e instalimit elektrik nr.0088936 të datës 27.01.2016, por që duke pasur parasysh mesataren e shpenzimeve të konsumatorit prej **851 kWh/muaj** (periudha 03/2016 – 06/2021), konsideron se konsumatorit kilovatorët - kWh e faturuar në korrigjimin plotësues duhet t'i korrigjohen në vlerë **-214.56€** duke bërë shpërndarjen e kWh për periudhën nëntë mujore 06/2015 deri në periudhën 02/2016. Gjithashtu DMK thekson se për diferencën e mbetur mes vlerës së ngarkuar përmes korrigjimit nr.93947DPR-90110761 të datës 20.02.2019 prej 744.96€ dhe korrigjimit financiar prej -214.56€, KESCO t'i ofroj konsumatorit një marrëveshje pagese me 9 këste mujore.

Bordi i ZRrE-së bazuar në transaksionet e konsumatorit dhe rrjedhën e energjisë elektrike konstaton se KEDS/KESCO kanë respektuar nenin 28 par. 1 dhe 2 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, ku thuhet se: *"1. Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shfrytëzuar dhe për taksat e tjera, në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me konsumatorin (nëse është e aplikueshme). 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar të zbatohet për cdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Furnizuesi ose Operatori i Sistemit për konsumatorët me tarifa të rregulluara në bazë të tarifave të miratuara nga ZRrE-ja dhe për konsumatorët e kualifikuar (me cmime të parregulluara), ashtu sic është rënë dakord në kontratën për furnizim".*



Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 02.09.2021 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Lutfije Dervishi, anëtare

Gani Buçaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO-së,
- Konsumatorit F.M. dhe,
- Arkivit të ZRRE-së